



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11 dhe 12.2 shkronja d) ndërlidhur me nenet 40 shkronja j) dhe 58 shkronja a) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal nr.04/L-010, Rregulloren nr.0203-1334 datë 18.12.2012 për procedurën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar, nenit 12 të Rregullores (MAPL) nr.02/2022 për procedurën e hartimit dhe publikimit e akteve të komunës, nenit 14 dhe 15 paragrafi 2.4, ndërlidhur me nenin 34 paragrafi 2.10 dhe nenin 61 paragrafi 1.1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e datës 31 tetor 2022, përkatësisht në vazhdimin e mbledhjes më 07 nëntor 2022, mori këtë,

V E N D I M

Neni 1

1. Miratohet kërkesa e Kryetarit të Komunës e datës 28 tetor 2022, për ndryshimin dhe plotësimin e vendimeve që ndërlidhen me nismën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar me Qytetin AMES në Shtetin IOWA të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe atë;

1.1. Vendimi i Kuvendit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-104/02-0065934/20 datë 30 tetor 2020 për miratimin e kërkesës – nismës së bashkëpunimit komunal ndërkombëtar – binjakëzimit me Qytetin AMES të Shtetit IOWA - SHBA, përkatësisht ish përfaqësuesi i Ekzekutivit (Nënkryetari i Komunës) si i autorizuar lidhur me këtë çështje, ndryshohet dhe plotësohet me emrin e z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës së Podujevës.

1.2. Vendimi i Kuvendit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-104/02-0065939/20 datë 30 tetor 2020 për autorizimin e fillimit të konsultimeve për bashkëpunim komunal ndërkombëtar-binjakëzim me qytetin AMES të Shtetit të IOWA në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim;

• *Neni 1 riformulohet:*

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës, autorizohet për fillimin e konsultimeve për vendosjen e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit në mes të Komunës së Podujevës dhe Qytetin AMES të Shtetit të IOWA në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

• *Neni 3 riformulohet:*

Draft Marrëveshja sipas neneve paraprake të këtij vendimi, nënshkruhet nga z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës së Podujevës, pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Pushtetit Lokal.

Neni 2

Arsyeja e ndryshimit dhe plotësimit të Vendimeve të cekura sipas këtij vendimi është për shkak të ndryshimeve në Ekzekutivin e Komunës si rezultat i procesit zgjedhor ku janë bërë ndryshime në udhëheqjen e qeverisjes në Komunën e Podujevës, dhe ka për qëllim vazhdimin dhe finalizimin e procesit të bashkëpunimit komunal ndërkombëtar filluar në vitin 2020 në mes të Komunës së Podujevës dhe Qytetit AMES të Shtetit të IOWA në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke i'u përshtatur aktualitetit të Ekzekutivit të Komunës së Podujevës, konkretisht dhënien e autorizimit Kryetarit të Komunës së Podujevës z.Shpejtim Bulliqi lidhur me këtë çështje ashtu siç përcaktohet me rregullativë ligjore.

Neni 3

Ky Vendim është pjesë përbërëse e:

-Vendimit nr.prot.01-104/02-0065934/20 datë 30 tetor 2020 për miratimin e kërkesës - nismës së bashkëpunimit komunal ndërkombëtar - binjakëzimit me Qytetin AMES të Shtetit IOWA – SHBA.

-Vendimit nr.prot.01-104/02-0065939/20 datë 30 tetor 2020 për autorizimin e fillimit të konsultimeve për bashkëpunim komunal ndërkombëtar - binjakëzim me qytetin AMES të Shtetit të IOWA në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.prot. 01-016/01-0093821/22
Podujevë, datë; 07 nëntor 2022



Kryesuesi i Kuvendit
Milmi Hoxha



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Për: KUVENDIN E KOMUNËS
Përmes: Komitetit për Politikë dhe Financa

Çështja: Propozim për përfshirje në kuadër të rendit të ditës

Të nderuarë,

Në vitin 2020, në Kuvendin e Komunës të Podujevës është miratuar Nisma për vendosjen e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar – binjakëzim me Qytetin Ames të shtetit të IOWA në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe njëkohësisht me vendim është autorizuar Nënkryetari i atëhershëm i Komunës (me emër mbiemër) për fillimin e konsultimeve për vendosjen e bashkëpunimit komunal – ndërkombëtar.

Në ndër kohë, pas procesit zgjedhor janë bërë ndryshime në udhëheqjen e qeverisjes në Komunën e Podujevës, me që rast edhe kanë vazhduar diskutimet dhe koordinimet me përfaqësues të Qytetit Ames të Shtetit të Bashkuara të Amerikës si dhe me nivelin qendrorë të Republikës së Kosovës si autoritet i ndërmjetëm në këtë proces.

Në këtë kontekst, kërkohet që Vendimet përkatëse lidhur me këtë çështje, të ndryshohen dhe plotësohen në Kuvendin e Komunës duke i'u përshtatur aktualitetit të Ekzekutivit të Komunës së Podujevës, konkretisht nenet ku figuron emri i ish përfaqësuesit të Ekzekutivit, të ndryshohen dhe të figuroj emri i Kryetarit të Komunës së Podujevës ashtu siç përcaktohet me rregullativë ligjore.

Çështje kjo e cila edhe kërkohet, për vazhdimin dhe finalizimin e procesit të bashkëpunimit komunal ndërkombëtar.

Andaj kërkoj që në kuadër të rendit të ditës për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e caktuar të mbahet më 31 tetor 2022, të shqyrtohet plotësim ndryshimi i vendimeve përkatëse, bashkëngjitur në këtë shkresë.

Me respekt,

Podujevë,
28 tetor 2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi

per: [signature]



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, dhe 40 shkronja j) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit për bashkëpunim ndërkombëtar nr.04/L-010, nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores së MAPL-së për procedurën e bashkëpunimit ndërkombëtar nr.0203-1334 të datës 18.12.2012, neneve 14 dhe 34 paragrafi 2.10 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/19, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, miratoi,

VENDIM PËR MIRATIMIN E KËRKESËS – NISMËS SË BASHKËPUNIMIT KOMUNAL NDËRKOMBËTAR – BINJAKËZIMIT ME QYTETIN AMES TË SHTETIT IOWA - SHBA

Neni 1

Miratohet kërkesa – nisma e z.Nexhmi Rudarit, Nënkryetar i Komunës në cilësinë e ushtruesit të detyrës dhe kompetencës së Kryetarit të Komunës së Podujevës, për vendosjen e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar – binjakëzimit me Qytetin Ames të shtetit të Iowa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës


Neni 2

z.Nexhmi Rudari, me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës do të autorizohet për fillimin e konsultimeve me përfaqësuesit e qytetit Ames dhe përgatitjen e draft Marrëveshjes për bashkëpunim të ndërsjellë.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.01-104/02-0065934/20
Podujevë,
30 tetor 2020





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 40 shkronja j) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit për bashkëpunim ndërkombëtar nr.04/L-010, nenit 6 paragrafi 3 të Rregullores së MAPL-së për procedurën e bashkëpunimit ndërkombëtar nr.0203-1334 të datës 18.12.2012, neneve 4 dhe 34 paragrafi 2.10 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/19, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, miratoi.

VENDIM

PËR AUTORIZIMIN E FILLIMIT TË KONSULTIMEVE PËR BASHKËPUNIM KOMUNAL NDËRKOMBËTAR – BINJAKËZIM ME QYTETIN AMES TË SHTETIT TË IOWA NË SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

Neni 1

z.Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, në cilësinë e ushtruesit të detyrës dhe kompetencës së Kryetarit të Komunës së Podujevës, të autorizohet për fillimin e konsultimeve për vendosjen e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit në mes të Komunës së Podujevës dhe Qytetit e Ames të shtetit të Iowa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Neni 2

Të identifikohen interesat e përbashkëta dhe në pajtim reciprok, konform legjislacionit në fuqi, të përgatitet draft Marrëveshja për bashkëpunim të ndërsjellë mes dy Qyteteve.

Neni 3

Draft Marrëveshja sipas neneve paraprahe të këtij vendimi, nënshkruhet nga z.Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, në cilësinë e ushtruesit të detyrës dhe kompetencës së Kryetarit të Komunës së Podujevës, pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Pushteti Lokal.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.01-104/02-0065939/20
Podujevë,
30 tetor 2020

